

DORACAK

për PRINDËR dhe NXËNËS





PËRMBAJTJA

Historiku.....	3
Misioni ynë.....	4
Rritja e cilësisë.....	4
Informimi i prindërve-nxënësve	7
Pritjet tona nga nxënësit.....	7
Rregullat e përgjithshme të funksionimit/veprimtarisë.....	9
I.Rregullat për hyrje dhe dalje nga shkolla.....	9
II.Rregullat e brendshme të shkollës.....	11
III.Edukimi.....	24
IV.Vëzhgimi, vlerësimi dhe zhvillimi i sjelljeve të nxënësve.....	35
Rregullorja për olimpiadë dhe projekte.....	41



HISTORIKU

Institucionet arsimore “Gulistan” janë hapur në dhjetor të vitit 1999 si rezultat i bashkëpunimit protokolar ndërmjet Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe institucioneve arsimore “Gulistan”. Në shkurt të vitit 2000 në Prishtinë u hap Kolegji “Mehmet Akif”, i cili me sukseset e veta për një kohë të shkurtër arriti të pëlqehet dhe të preferohet shumë nga populli i Kosovës. Që nga ajo kohë e deri më sot në kolegjet tona, në të cilat zhvillohet mësimi nga niveli 0, parashkollorë, fillorë dhe i mesëm, numri i nxënësve po rritet nga viti në vit. Kolegjet tona janë pishtarë të arsimit privat dhe më të mëdhatë në Kosovë. Këto shkolla fillimisht janë hapur në Prishtinë, kurse më vonë edhe në Prizren dhe Gjakovë.

1. Kolegji “Mehmet Akif “ Lipjan: Shkurt 2000
2. International School of Prishtina: Shkurt 2002
3. Kolegji “Mehmet Akif “ Prizren: Shtator 2006
4. Kolegji “Mehmet Akif “ Gjakovë: Shtator 2011



MISIONI YNË

Misioni ynë është edukimi i brezave të rinj që ta shprehin në mënyrë të lirë mendimin e tyre, që të jenë me vetëbesim të plotë dhe vetëkritikë; breza të rinj të cilët do t'i përvetësojnë, do t'i ruajnë dhe do t'i kultivojnë vlerat univerzale, etike, kulturore, shpirtërore, kombëtare dhe do ta respektojnë veten, familjen, atdheun, popullin e tyre dhe mbarë njerëzimin. Po ashtu përkushtimi i rëndësishëm së duhur, punës ekipore me anë të respektimit të parimeve të menaxhimit të cilësisë së përgjithshme në arsim, si dhe të jemi një institucion shembull për arsim.

RRITJA E CILËSISË

T'u ofrojmë nxënësve mundësinë që t'i shfrytëzojnë në tërësi shërbimet e arsimit cilësorë për të arritur suksesin e synuar.

Cilësia është përgjegjësia bazë e secilit punonjës që punon në institucionet tona. Kjo përgjegjësi mbahet në një ambient të mësimi motivues dhe mbështetës ku janë mundësitë e përtëritjes dhe vetë zhvillimit të personalitetit tonë në institucionet tona, në të cilat mbështetet çdo zhvillim i ri.

Një rëndësi e veçantë i kushtohet ngritjes së vazhdueshme të cilësisë duke e hulumtuar praktikën më të mirë të projekteve origjinale për t'ua dhënë në shërbim mësimdhënësve, nxënësve dhe prindërve.



Institucionet arsimore "Gulistan", synimet e cilësisë çdo vit i aktualizojnë duke i përcaktuar në bazë (nivel) të shkollave në përgjithësi dhe njërive brenda kornizës së filozofisë "zhvillim i vazhdueshëm"

Procedurat e cilësisë së institucioneve arsimore "Gulistan" përcaktohen brenda kornizës ligjore duke i vlerësuar mendimet, kërkesat dhe pritjet e nxënësve si dhe të prindërve. Kështu që gjatë këtij procesi të ngritjes së cilësisë mundësohet edhe pjesëmarrja e tyre.

Për zbatimin sa më efikas të parimeve të cilësisë institucionet arsimore "Gulistan" janë në konsultim dhe bashkëpunim të vazhdueshëm me përfaqësuesit e MASHT-it, zyrtarët tjerë, specialistët universitarë, partnerët e firmës, udhëheqësit e njërive mbështetëse dhe grupet tjera përgjegjëse. Bordi drejtues i institucioneve arsimore "Gulistan" premtan dhe siguron kontrollin e zbatimit të politikës së cilësisë që është caktuar për shërbimin arsimor të ofruar nga shkollat e veta.





International School of Prishtina

Prishtinë

Shkolla Internacionale e Prishtinës është hapur në vitin 2002 në Prishtinë dhe aktivitetin e saj e zhvillon në kuadër të Institucionit edukativo-arsimor “Gülistan”. ISP-ja në përbërje të saj me kopësht ose çerdhe, parashkollor dhe me shkollën fillore ofron një arsim dhe edukim të nivelit të lartë në një ambient të pastër, hapësirë të gjërë dhe harmonike për nxënësit.

Në ISP deri në klasën e 5-të mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe, kurse nga klasa e 6-të lëndët shkencore mësohen në gjuhën angleze, ndërsa lëndët shoqërore zhvillohen në gjuhën shqipe.

Në ISP rëndësi e veçantë iu kushtohet gjuhëve të huaja. Nga klasët e parashkollorëve intensivisht mësohet gjuha angleze nga mësimdhënësit adekuat, ndërsa gjuha turke si gjuhë e huaj e dytë mësohet duke filluar nga klasa e 6-të.

ISP-ja përveç arsimit dhe edukimit profesionist, nxënësve iu ofron edhe një ambient të këndshëm dhe mbështetje të madhe në zhvillimin e aftësive dhe prirjeve të veçanta, aktiviteteteve shoqërore, projekteve të ndryshme si dhe pjesëmarrjes në olimpiada shkencore.

ISP-ja, për klasët e 8-ta dhe të 9-ta e organizon Olimpiadën kombëtare të gjuhës angleze si dhe garën e matematikës (Prishtinë) për klasët e 5-ta.





INFORMIMI I PRINDËRVE-NXËNËSVE

ÇFARË PRESIM NGA NXËNËSIT

Nxënësi i Kolegjit “Mehmet Akif” dhe “International School of Prishtina”

1. Sillet në harmoni me rregullat e kodit të mirësjelljes dhe të respektit ndaj shokëve/qeve, mësëmdhënësve dhe administratorëve
2. Është i kujdesshëm në sjellje gjatë aktiviteteve brenda dhe jashtë shkollës si dhe gjatë ardhjes-shkuarjes nga shkolla. Mbanë përgjegjësi të plotë për sjelljet e veta.
3. I kushton kujdes të veçantë përgatitjes për mësim me mjete mësimore.
4. Është i kujdesshëm gjatë shfrytëzimit të inventarit të shkollës. Kujdeset për higjienën në ambientin ku qëndron.
5. Bënë zgjidhjen e problemeve. Është anëtar i mirë i grupit.
6. Është i vetëdijshëm për përgjegjësitë që i bartë ndaj shoqërisë në të cilën gjendet.
7. Merrë pjesë në të gjitha festat zyrtare dhe në ceremoninë e mënjesit.
8. I respekton të gjitha rregulloret e MASHT -it.

ÇFARË PRESIM NGA PRINDËRIT

·Ta mundësojë çdo ditë ardhjen e nxënësit me kohë në shkollë, i motivuar për mësim dhe në bazë të rregullave (të uniformës, pamjes së jashtme etj.) të shkollës.



·T'i mbështesë edhe në shtëpi rregullat , zbatimin dhe masat disiplinore të caktuara nga shkolla.

·Ta përcjell zhvillimin e nxënësit dhe për zgjidhjen e ndonjë problemi akademik dhe/ose në sjellje të fëmijës të bashkëpunojë me kujdestarin e klasës, personin orientues ose drejtorinë e shkollës.

·Në rast të mungesës së fëmijës për shkaqe të ndryshme (sëmundje etj.) ta lajmërojë drejtorinë e shkollës.

·Ta lexojë me vëmendje Doracakun për prind-nxënës për t'i marrë masat preventative që fëmija t'i respektojë të gjitha rregullat e shkollës që kanë të bëjnë me rendin e brendshëm.

·Ta lajmërojë me kohë shkollën rreth zhvillimeve psikike dhe fizike të fëmijës.

·Ta plotësojë me kohë dhe saktë çdo lloj ankete apo formulari të dërguar nga shkolla.

·Sipas nevojës t'i ndihmojë dhe ta udhëzojë fëmijën në kryejën e detyrave të shtëpisë dhe projekteve.

·Gjatë procesit mësimor të mos shetisë nëpër kate të shkollës kur mbahet mësimi.

·Në aktivitetet jashtëshkollore marrja me kohë e fëmijës, në mënyrë që të mos presë fëmija.

· Ta përcjellë orarin e mësimi të nxënësve.

·Të marrë pjesë rregullisht në mbledhjet e prindërve.

·Dhënia e saktë e informacioneve në fillim të vitit me që gjatë vitit shkollor informimi i prindërve bëhet me anë të telefonit dhe e-mail adresës.



KONSULTIMET PRIND - MËSIMDHËNËS

·Në fillim të vitit përgatitet orari i konsultimeve javore mësimdhënës-prind dhe njoftohen prindërit për këtë orar.

·Konsultimet javore mësimdhënës –prind fillojnë 2 javë pas fillimit të gjysmëvjetorit të I-rë dhe të II-të dhe përfundojnë 2 javë para përfundimit (dhënies së librezave) të gjysmëvjetorëve.

·Përveç takimeve javore brenda gjysmëvjetorëve organizohen “mbledhjet e përgjithshme të prindërve”. Data dhe ora e mbledhjeve caktohet në kalendarin e punës dhe para mbajtjes së mbledhjeve bëhet informimi i nevojshëm i prindërve.

·Në raste urgjente prindërit mund të aranzhojnë takime përmes zëvendësit përkatës dhe të konsultohen me mësimdhënësin.

RREGULLAT E PËRGJITHSHME

I. RREGULLAT PËR HYRIE-DALJE NGA SHKOLLA

Nxënësit

·Nxënësit tanë duhet të jenë në shkollë para ceremonisë së mënjesit.

· Nxënësit që dëshirojnë të dalin nga shkolla gjatë procesit mësimor mund të dalin vetëm me pëlqimin e zëvendësit përkatës dhe njoftimin me shkrim apo me telefonatë të prindit.

· Përveç shkaqeve shëndetësore nxënësit mund të largohen nga shkolla vetëm pas mbarimit të mësimi.

· Në rast të mungesës duhet ta lajmërojnë zëvendësin përgjegjës dhe kujdestarin/en e klasës me telefon.



Prindërit

·Përveç rasteve urgjente prindërit nuk duhet të kërkojnë leje dhe ta shkaktojnë ngecjen e nxënësit në mësim.

·Nëse prindi duhet ta marrë fëmijën gjatë orarit mësimor menjëherë duhet ta njoftojë zëvendësin përkatës. Kështu që me dijeninë e tij nxënësi merret nga klasa nga personat përgjegjës.

·Nxënësi u dorëzohet prindërve ose të afërmeve të tyre për të cilët prindi ka dhënë njoftim me shkrim. Mund të kërkohet dokumenti identifikues i të afërmit që e merr nxënësin.

·Përgjegjësia për nxënësin që merret gjatë orarit mësimor i takon të afërmit të vet që e merr.

TRANSPORTI I NXËNËSVE

·Bartja e nxënësve në shkollë është përgjegjësi e kompanisë së transportit. Shkolla nuk ka përgjegjësi për këtë, por e bënë vetëm kontrollimin.

·Nxënësit në mëngjes duhet të jenë në pikën e caktuar para ardhjes së mjetit transportues, në mënyrë që mos të presë transporti.

·Nxënësi që nuk del me kohë, nuk pritët dhe nuk mund të kërkojë ndonjë të drejtë!

·Në mjetet transportuese nxënësi nuk duhet të bëjë sjellje që i pengojnë ose i rrezikojnë të tjerët.

·Gjatë ardhjes në shkollë nxënësi nuk duhet ta hapë xhamin, ta nxjerrë kokën-duart jashtë apo të ngritet në këmbë.

·Gjatë udhëtimit nuk duhet të hanë ushqim.



- Obligohen që ta paguajnë dëmin që i shkaktojnë automjetit me paramendim ose pa qëllim.
- Në rast të ndonjë problemi apo ankese nuk duhet të fjalosen me vozitësin, por të lajmërohet përgjegjësi i kompanisë ose zëvendësi përkatës i shkollës.
- Ankesat në lidhje me transportin duhet t'i drejtohen kompanisë. Në rast të mos zgjidhjes së problemeve prindi duhet t'i drejtohet me shkrim drejtorisë së shkollës.
- Pa lejen e prindit nxënësi nuk lejohet që të zbresë përveç pikës së caktuar.
- Nxënësi duhet ta lajmërojë transportin (vozitësin) në qoftë se do të mungojë apo nuk do ta shfrytëzojë.
- Nxënësit duhet t'i kenë parasysh vërejtjet e mësimitdhënësit përgjegjës dhe të vozitësit si dhe t'i respektojnë ata.
- Prindi gjatë procesit të marrëveshjes duhet të njoftohet mirë për përgjegjësitë dhe detyrat në lidhje me bartjen e nxënësit në mënyrë të sigurtë dhe me kohë nga shtëpia në shkollë dhe anasjelltas.

II. RREGULLAT E BRENDSHME TË SHKOLLËS

Rregullat e klasës

- Të gjithë nxënësit nga dita e parë e shkollës janë të obliguar t'i respektojnë rregullat e klasës.
- Rregullat e klasës vlejnë për çdo lëndë. Edhe mësimitdhënësit lëndëve (kabinetet, atelietë, sallat e sportit etj.) i caktojnë bashkë me nxënësit rregullat e duhura ose mund të bëjnë ndryshime në rregulla sipas nevojës.
- Rregullat vlejnë gjatë tërë vitit shkollor, përveç se ndonjë ndryshimi.
- Nxënësi me kohë hynë në mësim dhe i përgatit mjetet mësimore.
- Kur bjen zilha për mësim nxënësit duhet të hyjnë para mësimitdhënësit në klasë, të ulen, t'i bëjnë përgatitjet për mësim dhe ta presin mësimitdhënësin.



- Mësimdhënësi kur hynë në klasë, nxënësi ngritet në këmbë dhe ulet pasi që ta përshëndesin.

- Gjatë orës mësimore nuk duhet ta prishin rendin e klasës duke u ngritur nga vendi për të marrë diçka (gjësende).

- Nxënësit duhet ta dëgjojnë mësimin dhe të jenë aktivë pa e prishur rendin dhe qetësinë në klasë.

- Gjatë orës së mësimi nxënësi nuk duhet të flasë.

- Gjatë mësimi nxënësit flasin vetëm me lejen e mësimdhënësit.

- Gjatë orës së mësimi nxënësi nuk duhet të dalë jashtë, përveç se në raste urgjente me lejen e mësimdhënësit.

- Gjatë orës së mësimi nuk duhet ngrënë ose pirë diçka dhe në asnjë mënyrë nuk duhet përtypur çamçakëz.

- Rendi dhe pastërtia e dollapit, tavolinës dhe bankës në klasë i takon nxënësit.

- Nxënësi gjatë orës së mësimi nuk duhet të ketë aksesori, ose të veshë diçka tjetër përveç uniformës së caktuar nga shkolla.

- Nxënësi i vonuar nuk mund të hyjë në mësim pa lejen e zëvendësit përkatës.

- Gjatë mësimi nxënësi nuk duhet të mirret me tema jashtëmësimore dhe të dekoncentrohet.

- Nxënësi edhe nëse do të flasë në lidhje me mësimin duhet të kërkojë leje për të folur. Nxënësi nuk duhet të tallet me shokët/qet, por duhet të krijojë raporte të mira shoqërore.

- Nxënësi në klasë duhet të ulet ashtu siç i ka hije nxënësit.

- Përveç rasteve kur ka ndonjë problem serioz shëndetësorë në raste tjera nxënësi nuk duhet të shkojë në infirmieri, por nëse duhet të shkojë, atëherë patjetër duhet të mirret leje nga zëvendës drejtori përkatës.

- Nxënësit nuk duhet të ulen mbi radiatorë ose te dritarja, por nuk duhet të lëshohet as nga dritarja dhe të bëjnë sjellje që do ta rrezikojnë sigurinë e tyre.

- Çdo nxënës është përgjegjës për bankën, tavolinën dhe dollapin e vet. Në rast të dëmtimit obligohet që ta kompenzojë dëmin.



Dhënia e lejes

· Në rast të mungesave të planifikuara drejtoria e shkollës dhe kujdestari duhet të lajmërohet një ditë më parë. Mirëpo nëse ndodhin papritmas (pa plan) atëherë drejtoria e shkollës dhe kujdestari duhet të lajmërohen brenda ditës.

· Nëse nuk ka raport mjekësor valid edhe nëse e ka treguar arsyen, nxënësit i shënohet mungesë për atë ditë apo ato ditë që ka munguar.

· Nxënësit duhet të vijnë me kohë në të gjitha aktivitetet që duhet të marrin pjesë (mësimet, ceremonitë zyrtare, aktivitetet shoqërore dhe shkencore etj.)

· Nëse nxënësi vjen me vonesë gjatë orës së parë të mësimit, për të hyrë në mësim obligohet që ta marrë fletëpranimin për mësim nga zëvendësi përkatës. Nxënësit që mungojnë janë të obliguar që t'i marrin detyrat e shtëpisë së asaj dite si dhe t'i kompenzojnë mangësitë e tyre. Nëse bëhet vlerësimi i këtyre detyrave, do ta marrë notën e merituar. Në të kundërtën nuk merr përgjegjësi as mësimdhënësi lëndor përkatës, as kujdestari.

· Të gjithë nxënësit obligohen që të marrin pjesë në ceremoninë e mëngjesit. Nxënësit që nuk marrin pjesë dërgohen në Këshillin për vlerësimin e sjelljeve të nxënësve.

MARRJA E LEJES NGA MËSIMI

Nxënësit vetëm me lejen e zëvendësdrejtorit përkatës mund të lirohen (sëmundje, përgatitje projekti, përgjegjësia për aktivitete shoqërore etj.) nga mësimi. Nxënësit nuk mund të marrin leje nga mësimdhënësi i lëndës.

Vonesa në mësim

Kur bjen zilja nxënësit duhet të jenë në klasë. Në rast të përsëritjes së vonesave të pa arsyeshme mirren këto masa:

- Vërejtje me gojë
- Informimi me shkrim i prindit (vërejtje me shkrim)
- Rasti dërgohet në Këshillin për vlerësim të sjelljeve të nxënësve



Rregullat e uniformës

Të gjithë nxënësit duhet t'i respektojnë kriteret e caktuara nga MASHT-i dhe Rregullores së uniformës-pamjes së jashtme nga Drejtoria e shkollës e cila bazohet në kriteret e MASHT –it.

Nxënësit të cilët këmbëngulin në mosrespektimin e rregullave të uniformës, që mbajnë aksesore të ndryshme, grimosen etj.dërgohen në Këshillin për vlerësim të sjelljeve të nxënësve.

Për nxënësit të cilët insistojnë në mosrespektimin e rregullave të uniformës mbahet procesverbali.

Rregullat e uniformës-pamjes së jashtme

Vajzat

- E veshin uniformën e caktuar nga Drejtoria. Nuk mund të bëjnë ndryshime mbi uniformë.
- Nuk mund të veshin rroba tepër të ngushta apo të gjëra.
- Brenda shkollës duhet të jetë koka e zbuluar, flokët duhet t'i kenë të pastra e të krehura, kurse nëse janë të gjata atëherë duhet t'i mbledhin prapa. Nuk duhet bërë grim, thonjtë s'duhen zgjatur dhe lyer me llak. S'duhet mbajtur unazë, vathë, zinxhirë, bylyzyk etj.
- S'duhet mbathur çizme të gjata deri te gjunjë dhe këpucë me taka të larta.
- Ndalohet ngjyrosja e flokëve. Flokët duhet të jenë të rregulluara.

Djemtë

- E veshin uniformën e caktuar nga Drejtoria.
- Nuk duhet të veshin modele tepër të ngushta ose të gjëra, pantallona kot, linoje si dhe veshje tjetër sportive, përveç asaj që është dhënë nga shkolla.
- Brenda shkollës nuk duhet mbajtur kapela, flokët duhet të jenë të shkurtëra dhe të pastra. S'duhet bartur aksesore, zinxhirë, unazë, vathë etj. Nuk lejohet tatuazhët.
- Duhet të rruhen në mënyrë të rregulltë.

Veshja sportive mund të vishet vetëm në orën e edukatës fizike dhe në ndeshjet sportive.



Gjësendet që s'duhet të sillen në shkollë

- Nxënësit që sjellin aparate elektronike (MP3, MP4, kamerë, gameboy, laptop etj.) duhet t'i dorëzojnë te zëvendësi përkatës.
- Përveç materialeve të kërkuara nga mësimdhënësi nuk mund të sillen në shkollë gjësendet (çdo lloj materiali për të bërë shaka, armë të ftohta prerëse, djegëse apo eksplozuese; botime që nuk u përshtaten moshës së tyre) mbajtja apo përdorimi i të cilave mund të shkaktojë ndonjë problem, apo do të ndikojë negativisht në zhvillimin fizik dhe psikik të nxënësve.
- Në shkollë nuk duhet të sillen gjësendet e çmueshme si dhe para më shumë se që ju duhen.
- Përgjegjësia për humbjen e gjësendeve të ndaluara i takon vetë nxënësit.
- Këto gjësende nëse nuk i dorëzohen drejtorisë mund të merren, konfiskohen nga ana e drejtorisë dhe pas mbajtjes së procesverbalit t'i kthehen vetëm prindit.
- Drejtoria e shkollës për parandalimin e rasteve problematike mund ta bëjë kontrollimin e herë pas herësh sipas nevojës

Telefoni mobil

- Nxënësit edhe nëse e kanë sjellë me vete telefonin mobil, kursesi nuk mund ta marrin në klasë. Duhet ta mbyllin dhe ta lënë në vendin e caktuar që u tregohet.
- Telefonat mobilë nuk mund të përdoren deri në mbarim të mësimin pa dijen dhe lejen e zëvendësdrejtorit.
- Nxënësitë bartin përgjegjësinë për telefonat që i kanë marrë me vete.
- Telefonat që janë konfiskuar për shkak të mosrespektimit të rregullave mbahen një javë dhe u dorëzohen vetëm prindërve. Në rast të përsëritjes telefoni mbahet deri në fund të gjysmëvjetorit.



Mehmet Akif College

Lipjan

Kolegji “Mehmet Akif” në Lipjan, në kuadër të Institucionit edukativo-arsimor “ Gülistan” nga viti 2000 e ka filluar aktivitetin e tij edukativo-arsimor. Në përputhje me marrëveshjen e protokollit të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës, mësimi zhvillohet në drejtimin shkencor.

Kolegji “Mehmet Akif” në Lipjan është një institucion shumë i suksesshëm edukativo-arsimor, gëzon një reputacion dhe emër të mirë, prandaj edhe nxënësit i përzgjedh nëpërmjet provimit pranues.

Lëndët shkencore zhvillohen në gjuhën angleze, lëndët shoqërore në gjuhën shqipe, ndërsa gjuha turke mësohet si gjuhë e huaj e dytë.

MAC-Lipjan e organizon Olimpiadën kombëtare të kimisë, por gjithashtu duke e përfaqësuar Kosovën nëpër garat ndërkombëtare, Kosovës i ka sjellur më shumë se njëqind medalje.

Prej 1024 maturantëve të diplomuar në MAC-Lipjan, shumë prej tyre studimet i vazhdojnë nëpër univeristete të ndryshme të botës si në Amerikë, Shqipëri, Turqi e po ashtu edhe në Kosovë.





Kantina dhe mensa

- Të gjithë nxënësit për t'u ushqyer shëndetshëm dhe mirë duhet të drekojnë në mensë.
- Blerjet nga kantina bëhen duke u rreshtuar/duke hyrë në radhë.
- Duhet të merren parasysh vërejtjet e mësimdhënësit kujdestarë në kantinë.
- Nxënësit nuk duhet ta pengojnë njëritjetrin me sjelljet e tyre.
- Blerja në kantinë ndërprehet me rënien e zilës.
- Nuk lejohet blerja nga kantina gjatë orës mësimore.
- Nuk duhet të hyjnë në dialogje të panevojshme me personelin e kantinës.
- Ardha në mensë për ngrënie duhet të jetë në kohën e caktuar nga drejtoria.
- Para dhe pas ngrënies duhet të pastrohen duart.
- Gjatë rreshtimit për ngrënie nxënësit duhet t'i respektojnë të drejtat e të tjerëve.
- Nuk vrapohet dhe nuk flitet me zë të lartë në mensë.
- Në mensë nuk sillen materialet e ndryshme si dhe materialet dhe pajisjet sportive.
- Ushqimi dhe gjësendet tjera në tavolinë nuk mund të përdoren si lodër.
- Nxënësit duhet ta ruajnë ushqimin e tyre.
- Duhet të mirren parasysh vërejtjet e mësimdhënësve dhe përgjegjësve të caktuar në mensë.
- Nxënësit duhet të hanë ushqim në tryezën e caktuar për ta.
- Ushqimi duhet të hahet me edukatë.
- S'duhet nxjerrë ushqim jashtë mensës.
- Nxënësi duhet të marrë ushqim aq sa mund të hajë.
- Tabakatë e ushqimit apo pjatat nxënësit duhet t'i lënë në vendin e caktuar nga përgjegjësi i mensës.



Infermiera

Nxënësi i cili për shkak të sëmundjes dëshiron që të shkojë në infermieri duhet të veprojë kështu:

- Merr leje nga mësimdhënësi dhe shkon te zëvendësi për ta marrë fletëlejen për infermieri. Nxënësi pasi që të kontrollohet shkon te zëvendësi me fletën e nënshkruar nga mjeku i shkollës dhe kthehet në klasë, ia jep fletëlejen për infermieri mësimdhënësit për ta lënë në ditar të klasës.

- Mjeku i shkollës (personi përgjegjës) në mënyrë sistematike i regjistron të dhënat shëndetësore të nxënësve. Njëkohësisht bëhet edhe regjistrimi i të gjitha punëve të kryera gjatë vitit.

- Gjatë regjistrimit të nxënësit në shkollë nga prindi kërkohet të plotësohet formulari shëndetësorë për nxënësin i cili përmban të dhënat shëndetësore (vaksinat, alergjitë, barnat e palejueshme, të dhënat specifike shëndetësore etj.). Plotësimi i plotë dhe i saktë i këtyre të dhënave ka rëndësi jetike.

- Në rast të ndonjë problemi serioz përgjegjësi shëndetësor ose zëvendësi i shkollës e njofton familjen. Sipas nevojës me pëlqimin e prindit nxënësi dërgohet në qendrën më të afërt shëndetësore nga ana e shkollës.

- Prindi, pa humbur kohë e njofton përgjegjësin shëndetësorë të shkollës për intervenimet mjekësore që janë kryer jashtë shkollës.

- Në raste urgjente, për ta informuar prindin sa më parë, është e obligueshme që të jepen të gjitha ndryshimet kontaktuese me kohë në sektorin e shërbimeve për nxënësin.



Biblioteka

· Shfrytëzimi i bibliotekës nga ana e nxënësve përcillet nga kujdestari dhe personi përgjegjës i bibliotekës.

· Librat që janë marrë nga raftet pasi që të mësohen vendosen mbi tavolinë.

· Në bibliotekë nuk flitet me zë të lartë.

· Librat, pajisjet dhe materiali i bibliotekës përdoret me kujdes të veçantë.

· Në bibliotekë nuk hyhet me ushqim-pije apo me material që nuk ka të bëjë me bibliotekë.

· Asnjë material nuk mirret pa leje.

Kushtet për huazim

· Secilit nxënës mund të jepen nga 2 botime për 2 javë. Nxënësi i cili nuk arrin të kryej punë gjatë kësaj kohe, i kthen botimet në bibliotekë dhe kërkon që afati i dorëzimit t'i shtyhet edhe një javë.

· Nëse nxënësit apo shfrytëzuesit tjerë kanë nevojë për ato botime afati i dorëzimit të librave mund të mos shtyhet.

· Në rast të dëmtimit të librave të huazuara kërkohet që të përtërihet (të blehet) i njëjti botim. Nëse botimi nuk gjendet në treg dhe nuk dihet çmimi, atëherë shkolla në bashkëpunim me njësinë e financave bënë caktimin e shumës për pagesë.





Salla e konferencës dhe kinemaja

·Në rast të ndonjë aktiviteti nxënësit së bashku me mësimdhënësin përgjegjës shkojnë aty ku zhvillohet aktiviteti.

- Nxënësit rreshtohen, hyjnë në sallë dhe ulen në vendet e caktuara më parë.
- Në sallë s'duhet të flitet me zë të lartë.

·S'duhet të sillet ushqim dhe pije si dhe të dëmtohet inventari i sallës.

·S'duhet të sillen gjësende të ndryshme në sallë, përveç atyre të lejuara nga mësimdhënësi.

·Gjatë programit duhet të jenë të qetë.

·Nxënësit s'duhet të hyjnë dhe të dalin pa leje nga salla.

·Në përfundim të programit nxënësit dalin nga salla duke u rreshtuar dhe nën kontrollin e mësimdhënësit përgjegjës.

Shfrytëzimi i oborrit

·Nxënësit duhet t'i përfillin udhëzimet e të gjithë mësimdhënësve dhe të punonjësve të institucionit arsimor “Gulistan”.

·S'duhet të flitet me zë të lartë në oborr.

·Nxënësit duhet t'i kenë parasysh rregullat e komunikimit, të mos flasin fjalë të ndyra dhe të mos jenë arrogantë.

·Të gjithë nxënësit duhet ta ruajnë me kujdes ambientin e natyrshëm në oborr.

·Nxënësit s'duhet të hipin mbi muri apo rrethojnë e oborrit. Në të kundërtën përgjegjësia i takon nxënësit.

·Kur vjen koha e mësimi gjësendet/materiali i përdorur në oborr duhet të vendoset përsëri në vend të vet.

- Në oborr nuk duhet të vrapohet me shpejtësi dhe të pengohen të tjerët me sjellje.
- Hapësirën apo pajisjet e ndara për një grup të caktuar të nxënësve nuk mund ta marrin nxënësit tjerë.
- Në oborr nuk mund të gjenden pajisjet që s'duhet të qëndrojnë në shkollë apo në klasë.
- Me të dëgjuar zilen që tregon se ka mbaruar pushimi, nxënësit kthehen në klasë në mënyrë të rregullt duke u dhënë përparësi nxënësve të vegjël. Njëkohësisht i përfillin udhëzimet e mësimdhënësve përgjegjës.
- Nxënësit qëndrojnë në një hapësirë të mbyllur nën mbikëqyrjen e mësimdhënësit gjatë pushimeve, nëse është moti i ftohtë ose me të reshura.

Salla e sportit

- Hyrja dhe dalja nga salla duhet të jetë në një rend të caktuar dhe në qetësi.
- Nxënësit në orën e Edukatës Fizike duhet ta veshin veshjen e caktuar sportive nga drejtorja.
- Nxënësit duhet t'i ndërrojnë këpucët kur hyjnë në sallë.
- Pajisjet e sallës nuk mund të shfrytëzohen apo të përdoren pa leje.
- Nxënësit duhet të kenë kujdes gjatë shfrytëzimit të zhveshtores.
- Nuk lejohet hyrja në sallë pa leje, përveç orëve të mësimi.
- Nxënësi i cili i dëmton pajisjet e sallës sportive është i obliguar që ta kompensojë dëmin e shkaktuar.
- Para mbarimit të orës (5 min) nxënësit duhet të shkojnë në zhveshtore për t'u përgatitur për orën vijuese dhe me mbarimin e orës e lëshojnë sallën e sportit në mënyrë të rregullt.
- Nxënësit që nuk mund të marrin pjesë në Edukatë Fizike për arsye të ndryshme duhet të qëndrojnë aty ku mbahet mësimi.



Laboratorët

- Laboratori hapet nën mbikqyrjen e mësimit dhe në laborator duhet shkuar me mësimit përgjegjës
- Në mbarim të mësimit fiken kompjuterët dhe pajisjet tjera sipas rregullave dhe vendosen në vendet e veta.
- Me kujdes shfrytëzohen kompjuterët dhe materiali i kabineteve.
- Në rast të dëmtimit të materialeve shkolla ka të drejtë të kërkojë kompensim, ndërsa prindi obligohet që ta paguaj dëmin e shkaktuar.
- Kompjuterat dhe pajisjet tjera nuk mund të përdoren për lojë/argëtim.
- Interneti shfrytëzohet nën kujdesin e mësimit të informatikës.
- Kabinetet dhe pajisjet tjera nuk mund të përdoren jashtë mësimit pa leje dhe pa mbikqyrje.
- Praktika e lëndëve shkencore nëpër kabinete kryhet nën mbikqyrjen e mësimit lëndor dhe mësimit të kabineteve.
- Shkuarja nëpër të gjitha laboratorët bëhet me shoqërimin e mësimit, me radhë dhe pa zhurmë.
- Nxënësit obligohen që ta ruajnë materialin që u është dhënë për ta kryer anën praktike të mësimit nëpër kabinete.

Siguria

- Nxënësit që dalin me leje nga shkolla janë të obliguar që fletëlejen t'ia tregojnë punëtorit të sigurimit të shkollës.
- Gjatë hyrjes-daljes ose në rastet emergjente nxënësit duhet t'i respektojnë udhëzimet e sigurimit të shkollës.
- Vizitorët që vijnë me nxënësit apo me prind dokumentin identifikues duhet t'ia tregojnë punonjësit të shkollës.
- Nxënësit duhet t'i respektojnë punonjësit e sigurimit.



Mehmet Akif College

Prizren

Kolegji “Mehmet Akif-” në Prizren nga viti 2006, në kuadër të Institucionit edukativo-arsimor “Gülistan”, e ka filluar aktivitetin e tij edukativo-arsimor. MAC-Prizren me parashkollë, shkollë fillore dhe të mesme të ulët, është duke e vazhduar aktivitetin e tij, kurse shkolla e mesme e lartë mësimin e zhvillon në drejtimin shkencor.

Në MAC-Prizren deri në klasën e 5-të mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe. Prej klasës së 6-të lëndët shkencore zhvillohen në gjuhën angleze, lëndët shoqërore në gjuhën shqipe, ndërsa gjuha turke mësohet si gjuhë e huaj e dytë.

Në MAC-Prizren rëndësi e veçantë iu kushtohet projekteve të garave ndërkombëtare, punimeve të ndryshme nëpër olimpiada të lëndëve si fizikë, kimi, biologji, matematikë, informatikë si dhe për nxënësit e talentuar në lëmi të ndryshme ofrohet një mbështetje e jashtëzakonshme. MAC-Prizren ka arritur shumë suksese në olimpiadat shkencore dhe projektet e garave ndërkombëtare.

MAC-Prizren e organizon edhe Garën e matematikës (Prizren) për klasët e 5-ta. Prej 153 nxënësve që kanë diplomuar në MAC-Prizren, nxënësit e suksesshëm i vazhdojnë studimet e tyre në vende të ndryshme të Evropës si dhe në Kosovë, Turqi e Shqipëri.





III. EDUKIMI

INFORMATA TË PËRGJITHSHME

· Në shkollën fillore(kl.1-5) mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe.Gjuha angleze mësohet në mënyrë intensive si gjuhë e dytë e huaj.

· Në shkollën e mesme të ulët (6-9) dhe shkollën e mesme të lartë (10-12) lëndët shkenore (Matematikë, Fizikë, Kimi, Biologji, Informatikë...) zhvillohen në gjuhën angleze. Ndërsa lëndët shoqërore (Gjuhë Shqipe, Histori, Gjeografi ...) zhvillohen në gjuhën shqipe.

· Në shkollat tona një orë e mësimi zgjat 45 min. Pajisjet teknologjike për edukim nëpër kabinete dhe klasa përdoren në mënyrë aktive nga mësimmshënësit. Orët e mësimi mbështeten me materiale të ndryshme të përgatitura duke pasur parasysh dallimet individuale. Në shkollat tona thelbësore është që tema të kuptohet në klasë nga nxënësit.

· Në shkollat tona datat e provimit caktohen para fillimit të vitit shkollor nëpër mbledhje të aktiviti dhe pastaj shpallen. Në të njëjtën ditë dhe orë mbahen provimet e të gjitha lëndëve. Krahas provimeve me shkrim për të parë gjendjen e përgjithshme të nxënësve, në periudha të caktuara mbahen edhe provime testuese për të cilat njoftohen prindërit.

· Për të shpejtuar zhvillimin individual të nxënësve , për zbulimin e talenteve të tyre, dhe për ta rritur vetëbesimin në shkollat tona mbahen edhe aktivitete të ndryshme të klubeve.

· Për të ngjallur motivimin e nxënësve gjatë aktiviteteve të ngjeshura arsimore dhe për të mësuar më mirë, në shkollat tona organozohen edhe aktivitete të lira dhe shëtitje të ndryshme. Duke pasur parasysh zhvillimin social dhe personal të nxënësve realizohen shëtitje me karakter arsimor që kanë të bëjnë me tema të zhvilluara mësimore, vizita nëpër vende turistike e historike të Kosovës si dhe jashtë vendit.



Detyrat dhe punimet

·Nxënësit duhet t'i kryejnë me kohë dhe ashtu siç kërkohen detyrat e shtëpisë dhe punimet. Nxënësit detyrat duhet t'i kryejnë në shtëpi e jo t'i përshkruajnë nga të tjerët.

· Nuk duhet të mirret si arsytim për moskryerjen e detyrave mosdëgjimi i nxënësit ose mosqenia në klasë derisa janë dhënë detyrat.

PROGRAMI PËR TË MËSUAR-MODEL

18:00 – 19:00	Kryerja e detyrave
19:00 – 20:00	Darka dhe pushimi
20:00 - 21:00	Mësim (përsëritje)
21:00 – 21:30	Koha për lexim
21:30 – 21:45	Pastrimi dhe përgatitja për gjumë
22:00	Koha e gjumit





Provimet dhe sistemi i notimit

· Të gjitha provimet që do të mbahen brenda vitit caktohen në fillim të vitit në mbledhjet e aktiveve dhe shënohen në kalendar.

· Krahas provimeve kalendarike nxënësit u nënshtrohen edhe provimeve "Testi për vlerësim të temës" dhe "Provimi për vlerësim të përgjithshëm."

· Para provimit nxënësi obligohet që t'i ketë me vete përgatitjet e duhura (laps grafik, gomë, mprehëse etj.) për provim.

· Gjatë provimit s'duhet të ketë mbi tavolinë të punës(bankë) fletore, libër, shënime etj apo literaturë mbështetëse për provim.

· Obligohet që t'i lexojë me vëmendje sqarimet për fletëprovim si dhe të dëgjojë dhe të zbatojë me vëmendje sqarimet me gojë.

· Nëse nxënësi nuk e ka të qartë pyetjen atëherë me lejen e mësimitdhënësit e ngrit dorën lartë dhe pret në qetësi dhënien e lejes së e mësimitdhënësit për ta pyetur.

· Pasi të fillojë provimi nuk mund të bëhet ndonjë koment në lidhje me provim.

· I vetmi person kompetent në lidhje me ndarjen e grupeve, ndarjen dhe mbeldhjen e pyetësorëve-testeve është mësimitdhënësi.

· Marrja dhe dhënia e kopjes gjatë provimit ndëshkohet nga komisioni disiplinor.

· Gjatë provimit nxënësi s'duhet të flasë, ta shikojë fletën e tjetrit ose ta ngrisë fletën për të parë të tjerët. Rastet e tilla cilësohen si "kopje".

· I anulohet testi/provimi nxënësit që kopjon dhe vlerësohet me notën "1". Mësimitdhënësi i lëndës rastin e paraqet në drejtorinë e shkollës.

· Në mbarim të kohës së provimit pyetësorët dhe fletëpërgjigjet duhet të dorëzohen ashtu siç kërkohet dhe në kohën e duhur.

· Derisa të mos bie zilja apo të mos jep leje mësimitdhënësi nuk duhet të lëshohet salla e provimit.

· Nxënësit që kanë raport mjekësor ose që janë të liruar nga provimi janë të obliguar që të jenë prezentë në datën dhe kohën e caktuar për ta mbajtur provimin justifikues. Në të kundërtën e humbin të drejtën e nënshtrimit në provim dhe notohen me notën “1”.

· Njohtohet prindi i nxënësit i cili nuk iu ka nënshtruar provimit, nuk i ka kryer detyrat dhe nuk i ka dorëzuar projektet me kohë. Lidhur me këtë prindi arsyetimin me shkrim duhet t’ia dorëzojë drejtorisë së dhkollës më së voni brenda 5 ditëve të punës.

· Provimet, projektet dhe punimet e nxënësve vlerësohen me poena nga 0-100. Rezultatet e vlerësimit-poenave regjistrohen në tabelën e notimit që gjendet në sistemin e-shkolla.

Më poshtë është dhënë vlerësimi me notë i poenave dhe niveli i suksesit

PIKËT	NOTA	SUKSESI
85-100	5	Shkëlqyeshëm
70-84	4	Shumë mirë
55-69	3	Mirë
45-54	2	Mjaftueshëm
0-44	1	Pa sukses/dobët

Nota e gjysmëvjetorit dhe e fundvitit caktohet në bazë të dispozitave të Rregullores sipas sistemit të notimit.





Programi për orë shtesë

· Pas përfundimit të mësimit të rregullt ose në fund të javës sipas kohës së lirë që kanë mësime nxënës të lëndorë për nxënës tanë mbahen orë shtesë (OFIS) për të cilat nxënës njoftohen më parë.

· Nga nxënës tanë nuk kërkohet ndonjë pagesë shtesë për këto orë të mësimit.

· Orët shtesë organizohen në bazë të rezultatit të matjes së vlerësimit të nxënës nga mësime të lëndës.

· Nxënësi mangësitë e veta duhet t'i plotësojë vetë. Kjo do t'i ndihmojë që njohuritë e tij të jenë të përhershme.

· Orët shtesë-OFIS mbahen me grupe të vogla.

· Nëse nxënësi nuk i ka bërë detyrat e shtëpisë për ta përforcuar temën dhe arsimtari ka raportuar se nxënësi nuk e ka dëgjuar mësimin në mënyrë efektive për ta kuptuar në klasë atëherë nuk pranohet në orët shtesë-OFIS.

· Nxënësi në radhë të parë duhet t'i kryejë obligimet e veta si nxënës (ta dëgjojë mësimin, të bëjë përsëritje , t'i bëjë detyra etj.)

· Të gjithë nxënës të cilët kryejnë obligimet e veta dhe që kanë nevojë për orë shtesë mund të marrin pjesë në këtë program OFIS (orë shtesë).

· Shpenzimet e transportit dhe të ushqimit të këtyre nxënësve pjesëmarrës i kryejnë prindërit. Shkolla nuk mban përgjegjësi për këtë gjë.

Edukimi/arsimi në gjuhë angleze

Në Kolegjin “Mehmet Akif” dhe “International School of Prishtina” arsimi në gjuhën angleze ka një strukturë që përputhet me standardet e Bashkimit Evropian-BE.

·Oxford placement tests.

·Kurset SAT-TOEFL .

·Praktikimi i fletëpunës “Worksheet”



- Shkollat e gjuhës të realizuara në Angli dhe Amerikë

- Shkolla për gjuhë angleze brenda vendit.

- Aktivitetet për praktikimin e gjuhës angleze
(PET DAY – HOBBY DAY –MOVIE DAY)

- Readers (Lekyra në gjuhën angleze)

Sistemi i Informacioneve për Nxënës-SIN

Sistemi i Informacionit për Nxënës-SIN është një sistem web-based në të cilin regjistrohen vlerësimet e nxënësit për pjesëmarrje në mësim, uniforme, sjellje dhe detyra.

- Mësimdhënësi informacionet në lidhje me nxënësin i regjistron në këtë sistem. Kështu që nxënësi dhe prindi me anë të fjalëkalimit mund të informohen për çdo gjë. Prindi ka mundësi ta kontrollojë gjendjen e fëmijës së tij në mësim dhe disiplinë.

- Në institucionet e arsimit formal në edukimin e brezave “ përcjellja-vëzhgimi i nxënësit” është njëri ndër faktorët kryesorë që ndikon në suksesin e këtyre institucioneve. Fjala që përdoret këtu “vëzhgim” nuk duhet të kuptohet si një lloj presioni apo si diçka që e bezdis nxënësin. Përkundrazi me këtë fjalë nënkuptojmë një vëzhgim motivues që e shtyn nxënësin për ta vënë në funksion arsyen dhe që e orienton për suksese të mëtutjeshme. Mendojmë se disiplina nuk mund të arrihet me dhunë dhe presion. Vëzhgimi është një faktor me rëndësi për të pasur disiplina. Me anë të Sistemit të Informacionit për Nxënës-SIN shkolla, mësimdhënësit dhe prindërit kanë më tepër mundësi që ta përcjellin/vëzhgojnë nxënësin.

- Programi SIN u mundëson prindërve njoftime ditore dhe javore për sjelljet e mira dhe jo të mira të nxënësit.Për vlerësimin e nxënësit nuk merret parasysh vetëm mendimi i një mësimdhënësi, por mendimi i përbashkët i të gjithë mësimdhënësve që i japin mësim nxënësit.



· Në bazë të programit SIN shpërblehen sjelljet e mira, kështu që mund të parandalohen edhe sjelljet jo të mira. Nëse kjo metodë nuk ka efekt bisedohet individualisht me fëmijën. Nëse nuk ka përmirësime atëherë thirret prindi në shkollë. Ky sistem ndihmon shumë që vërejtjet të bëhen me vend dhe në bazë të qëndrimit të përbashkët .

· Me anë të fjalëkalimit që u është dhënë mund të njohtoheni me informatat në SIN të fëmijës tuaj përmes web faqeve: mackosova.com; macprizren.net; ispkosova.com; macgjakova.com

Udhëzimi dhe këshillimi pedagogjik

· Veprimtaria jonë si Shërbim për Udhëzim dhe Këshillim Psikologjik dedikuar nxënësve të cilët janë në zhvillim e sipër bazohet në katër parime kryesore: njohja e nxënësit, udhëzimi i nxënësit, mbështetja dhe vëzhgimi i nxënësit.

· Për t'u njohur me vetveten, për t'i zgjidhur problemet, për të marrë vendim real, për ta zhvilluar kapacitetin ashtu siç ju duhet dhe për t'iu përshtatur në mënyrë të shëndoshë dhe të duhur ambientit të vet, nxënësve tanë u ofrohet edhe këshillim individual.

· Për t'ju ndihmuar prindërve për zgjidhjen e problemeve që kanë me fëmijët dhe për një komunikim më të shëndoshë ndërmjet veti vazhdojnë përpjekjet edhe për udhëzimin e prindërve. Kështu që në këtë mënyrë jepet një kontribut i rëndësishëm për lumturinë edhe të anëtarëve tjerë të familjes e jo vetëm zhvillimit të nxënëve tanë.

· Institucioni ynë ka për synim edukimin e njeriut model i cili mund ta formësojë botën e së ardhmes, punëtorë, me vetëbesim, tolerantë dhe i dashur për të gjithë, i cili mund të harmonizojë vlerat kulturore me të kuptuarit e shkencës moderne.

· Me punën që realizohet kontribuohet në zhvillimin e nxënësve tanë si individë të lumtur, të shëndoshë, të kompletuar në çdo aspekt për t'u ballafaquar me të gjitha vështësitë që mund të ballafaqohen.



·Janë disa raste ku mësimdhënësi duhet ta njohë, fëmijën edhe brenda raporteve shoqërore. Ka nevojë që ta verifikojë mënyren e komunikimit të anëtarëve të grupit dhe raportin shoqëror mes anëtarëve të grupit.

·Me anë të Sistemit të Informimit për Nxënës vlerësohen sjelljet e nxënësve dhe njohtohen prindërit. Qëllimi i kësaj është që nxënësit tanë t'i përfitojnë shprehitë e sjelljeve të mira, kurse prindërit të përfshihen sado pak në procesin mësimor, kështu që të përforcohet bashkëpunimi shkollë-familje dhe të përvetësohen më mirë rregullat e shkollës.

·Me anë të seminareve dedikuar nxënësve tanë dhe shkollës për nënë-babë që praktikohen herë pas here, bëhet njohtimi i nxënësve dhe prindërve në lidhje me çështje të ndryshme të nevojshme. Informimi bëhet edhe përmes panove dhe fletushkave të ndryshme.

Aktivitetet e klubeve

· Në procesin edukativo – arsimor krahas suksesit në mësim është me rëndësi edhe zhvillimi social i nxënësve si dhe zhvillimi i tyre si individë me shumë vetëbesim. Për ta arritur këtë duhet të zbulohen dhe të zhvillohen talentet e tyre. Për këtë arsye në shkollat tona nxënësit varësisht prej dëshirës së tyre kanë mundësi të aktivizohen nëpër klube të ndryshme sociale, sportive, kulturore dhe shkencore.

· Përzgjedhja e klubeve bëhet në fillim të vitit duke e plotësuar formularin për zgjedhjen e klubit duke i orientuar mësimdhënësit dhe prindërit. Në veçanti aktivitetet sociale në shkollën fillore kanë një ndikim të posaçëm për të ardhmen e nxënësit. Mundësitë që i ofron shkolla për këto aktivitete të lira brenda shkollës edhe prindi duhet të mundohet që t'ia ofrojë nxënësit jashtë shkollës. Për këtë arsye kur bëhet përzgjedhja e klubeve, prindërit duhet të jenë shumë të kujdesshëm.



Çështjet që duhet të merren parasysh në përzgjedhjen e klubit

- Çdo nxënës mund t'i preferojë tri klube të ndryshme varësisht prej talentit që ka dhe në cilën klasë është.
- Përcaktimi i nxënësve nëpër klube bëhet në bazë të konsultimeve të kujdestarit të klasës dhe arsimtarit orientues si dhe merren parasysh vendet e lira që gjenden në klub.
- Nxënësit duhet ta sjellin materialin e nevojshme për ta kryer punën e ditës përkatëse.
- Klubet do të formohen dhe do të përzgjedhen gjatë vitit shkollor 2013-2014. Prindërit së bashku me nxënësin duhet ta bëjnë me kujdes përzgjedhjen e klubit, gjithnjë duke u bazuar në aftësitë dhe talentin e nxënësve .
- Nuk pranohen kërkesat për ndërrim të klubeve pasi që t'i fillojnë aktivitetet. Këto kërkesa mund të merren parasysh vetëm për arsye shëndetësore të aprovuara nga mjeku dhe me pëlqimin e shërbimit për Udhëzim dhe Këshillim Psikologjik si dhe me pëlqimin e mësimdhënësit orientues.
- Në fund të sezonit arsimor nxënësve do t'u jepet nga një certifikatë e klubit. Nxënësit të cilët kanë munguar dhe nuk kanë marrë pjesë nëpër aktivitete nuk do t'i marrin këto certifikata.
- Varësisht nga natyra e klubit materiali i nevojshëm duhet të sigurohet nga vetë nxënësi.
- Prindi pranon që fëmija i vetë të marrë pjesë nëpër gara kombëtare dhe ndërkombëtare që kanë të bëjnë me klubin, anëtar i të cilit është fëmija, me kusht që Drejtorja e shkollës t'i paralajmërojë prindërit më parë.
- Mund të shfrytëzohen salla të ndryshme për efekt më të mirë të aktiviteteve. Prindi pranon që ta dërgojë fëmijën në salla të caktuara nga Drejtorja e shkollës.



Bursat për nxënës

Bursë për sukses: Është bursë që u ofrohet çdo vit nxënësve që tregojnë sukses në provimin pranues për kl.6-të, 9-të dhe 10-të. Këto bursa caktohen dhe lajmërohen nga Bordi Drejtues. Shuma e bursës që e fiton nxënësi shpallet njëkohësisht me rezultatet e provimit.

- Për nxënësit e rinjë vlenë përqindja e zbritjes së shpallur nëpër gazeta në bazë të rezultatit të provimit pranues. Nëse ndonjë nxënës i cili gjendet në ranglistë nuk e bënë regjistrimin apo tërhiqet edhe atëherë nuk ndyshon përqindja e bursës së fituar.

- Nxënësit të cilët fitojnë bursë në provimin pranues për kl.6-të këtë bursë do ta shfrytëzojnë deri në fund të klasë së 8-të. Këta nxënës i nënshtrohen provimit pranues për kl.9-të dhe nëse tregojnë sukses mund të fitojnë përsëri bursë.

- Nxënësit që vijnë në mesimin në shkollat tona mund të hyjnë në provimin për bursë vetëm në kl. 9-të.

- Në shkollën tonë nëse janë 3 e më tepër paralele, 3 nxënësve të parë u jepet 50% bursë për sukses. Bursat janë njëvjeçare dhe caktohen në fund të çdo viti shkollor.

Zbritje për fëmijë (motër-vëlla): Kjo zbritje ka për qëllim mbështetjen e familjeve që kanë më tepër se një fëmijë në shkollat tona.

- Kjo zbritje bazohet jo vetëm në ngajshmërinë e mbiemrit, por edhe në emrat e prindërve (nënë-babë).

- Prindërit që dëshirojnë që ta shfrytëzojnë këtë zbritje duhet ta plotësojnë formularin e zbritjes për motër-vëlla gjatë regjistrimit.

- Zbritja për motër-vëlla vlenë vetëm për fëmijët e një familjeje dhe assesi nuk vlenë për fëmijët që kanë lidhje farefisnore.

- Brenda vitit shkollor nëse njëri prej fëmijëve(motër-vëlla) tërhiqet atëherë kjo zbritje nuk do të jetë valide për asnjërin.



Mehmet Akif College

Gjakovë

Kolegji “Mehmet Akif në Gjakovë në vitin 2011, në kuadër të Institucionit edukativo-arsimor Gülistan, e ka filluar aktivitetin e tij edukativo-arsimor. MAC-Gjakovë në përbërje të tij e ka çerdhen ose kopshtin, parashkollën, shkollë fillore dhe të mesme të ulët si dhe shkollën e mesme të lartë, në drejtimin shkencor.

Në MAC-Gjakovë, deri në klasën e 5-të mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe, kurse prej klasës së 6-të lëndët shkencore zhvillohen në gjuhën angleze, ndërsa lëndët shoqërore mësohen në gjuhën shqipe. Njëkohësisht gjuha turke mësohet si gjuhë e huaj e dytë.

Në MAC-Gjakovë rëndësi e veçantë iu kushtohet gjuhëve të huaja, prandaj mësimdhënësit adekuat nga klasët e parashkollorëve fillojnë t’ua mësojnë intenzivisht gjuhën angleze.

MAC-Gjakovë nxënësit e rinj i pranon për klasën e 1-rë, të 6-të, të 9-të dhe të 10-të. Për nxënësit e rinj të klasëve të 6-ta, të 9-ta dhe të 10-ta, mësimi zhvillohet në gjuhën angleze.

MAC-Gjakovë rëndësi të veçantë iu kushton projekteve dhe olimpiadave shkencore si dhe i mbështet të gjithë nxënësit që marrin pjesë në këto aktivitete. MAC-Gjakovë i organizon Garat e matematikës (Gjakovë) për klasët e 5-ta



www.macgjakova.com
facebook.com/macgjakova



IV. VËZHGIMI, VLERËSIMI DHE ZHVILLIMI I SJELLJEVE TË NXËNËSVE

Këshilli për vlerësim të sjelljeve të nxënësve

Në shkollat tona formohet Këshilli i cili i vëzhgon sjelljet e nxënësve. Këshilli për vlerësim të sjelljeve të nxënësve formohet nga mësimmhënësit e përzgjedhur nga ana e Këshillit të mësimmhënëseve të cilin e udhëheq zëvendës drejtori. Derisa arsyetimi nuk pranohet nga ana e drejtorisë së shkollës anëtarët e këshillit nuk mund të heqin dorë nga kjo detyrë.

Detyrat e Këshillit për vlerësim të sjelljeve të nxënësve (Komisioni disiplinor)

- Diskutimi i të gjitha propozimeve të bëra nga ana e drejtorisë së shkollës, mësimmhënëseve, personelit tjetër të shkollës, nxënësve apo prindërve lidhur me sjelljet pozitive dhe jopozitive si dhe zbatimet që kanë të bëjnë me vendosjen e rendit në shkollë.

- Përcaktimi dhe vendimi për shpërblim i nxënësve që janë të suksesshëm, të sjellshëm, pjesëmarrës aktivë në aktivitetet shkencore, artistike, shoqërore, kulturore dhe sportive.

- Analiza e sjelljeve të nxënësve që kanë vështirësi për t'u përshtatur; hulumtimi i shkaqeve të këtyre sjelljeve dhe vlerësimi i tyre; krijimi i mundësisë për t'u orientuar si dhe bashkëpunimi me prindër sipas nevojës.

- Propozimi për orientim në institucionet shëndetësore për përmirësimin e sjelljeve të pahijshme të nxënësve.

- Në korrigjimin e sjelljeve jo të hijshme: zhvillimi i vetëdijes për kritikë dhe vetëkritikë, shtyrja për të kuptuar sjelljet e gabuara dhe për t'i ndihmuar që t'i përvetësojnë sjelljet e mira duke i bindur dhe duke i shpërblyer për sjelljet e mira, e jo duke u bërë pengesa apo duke i dënuar.

- Angazhimi për t'u ndihmuar nxënësve për të marrë përgjegjësi, për të qenë të drejtë, besnikë, të respektuar dhe të suksesshëm; që të pengohet përfitimi i shprehive jo të mira dhe shkuarja në vende jo të përshtatshme. Mu për këtë qëllim krijimi i bashkëpunimit të mirëfilltë prind-ambienti/rrethi shoqëror.



- Organizimi dhe realizimi i programeve dhe aktiviteteve të ndryshme me qëllim që të funksionojë mirë rendi i shkollës .

- Marrja e vendimeve lidhur me dënimet që duhet ndërmarrë për nxënësit të cilët përkundër të gjitha masave nuk mund të përshtaten.

Sjelljet e pahijshme të nxënësve dhe ndëshkimet

Në bazë të Rregullores së Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë varësisht nga sjelljet e pahijshme të nxënësve të shkollës fillore dhe të mesme u shqiptohet dënimi: vërejtje, qortim dhe ndërrim të shkollës.

Qëllimi i këtyre masave është mbrojtja e rendit dhe shoqërisë që nxënësit të heqin dorë dhe të vetëdijesohen për sjelljet jo të mira që i bëjnë dhe të orientohen për t'u përmirësuar.

Duke pasur parasysh fazën e zhvillimit të nxënësve zbatohet ndëshkimi “vërejtje” për sjelljet që mund të korrigjohen me anë të vetëdijësimit. “Vërejtja” është një proces i cili zhvillohet në këtë mënyrë:

a) Vërejtje

1) Vërejtje me gojë (paralajmërim): Është një proces që përfshin konsultimet mësimdhënës-nxënës. Me anë të konsultimeve synohet që fëmija ta kuptojë arsyen pse nuk duhet të bëjë sjellje të pahijshme dhe se çfarë sjelljesh priten nga nxënësi. Nxënësi paralajmërohet për masat e mundshme që mund të merren ndaj tij në rast të vazhdimit të sjelljeve jo të mira.

2) Marrëveshja me shkrim me nxënësin: Në rast se edhe pas vërejtjes gojore vazhdojnë sjelljet jo të mira të nxënësve atëherë zhvillohet një bisedë/takim mes mësimdhënësve dhe nxënësit. Në fund të takimit nxënësi e nënshkruan një marrëveshje me të cilën premtan se do t'i korrigjojë sjelljet e veta.

3) Takimi me prind: Mësimdhënësi e fton prindin në shkollë nëse nxënësi vazhdon me sjellje jo të mira. Në këtë takim ku pjesëmarrës është edhe një nga administruesit e shkollës prindi njohtohet për masat që mund të merren ndaj nxënësit.



Në rast të mungesës së prindit/nëse prindi nuk i përgjigjet ftesës për këtë takim atëherë mbahet një procesverbal.

4) Nëse pas gjitha këtyre përpjekjeve edhe më tutje vazhdojnë sjelljet e pa hijshme të nxënësit, bëmësimdhënësi përgatit një raport të cilës ia bashkangjet dosjen që i përmban të gjitha dokumentet tjera me shkrim dhe këtë rast e paraqet te Këshilli për vlerësim të sjelljeve të nxënësit për diskutim.

b) Qortimi: Është njoftimi me shkrim i nxënësit nga ana e drejtorisë së shkollës se është duke bërë sjellje që kërkojnë masa dhe nuk duhet të përsëriten sjelljet e tilla.

c) Suspendimi: Njoftimi i nxënësit me shkrim se është i larguar përkohësisht nga objekti, oborri dhe kompleksi shkollorë dhe gjatë kësaj kohe nuk mund t'i shfrytëzojë të drejtat e statusit të nxënësit.

d) Ndërrimi i shkollës; Është transferimi i nxënësit nga shkolla në të cilën është duke vijuar mësimin në një shkollë tjetër.

Sjelljet që kërkojnë marrje të masës

a) Sjelljet që ndëshkohen me “vërejtje”;

- Vonesa në mësim dhe në aktivitetet tjera dhe përsëritja e sjelljeve të tilla pa arsytim.

- Bërja shprehi e mungesave pa arsye, mossjellja e arsytimit për mungesa dhe vazhdimi pa justifikim i lejes së marrë nga Drejtoria e shkollës.

- Sjellja dhe përdorimi i materialeve të ndaluara nga drejtoria.

- Të gënjyerit.

- Ndotja e bankave, mureve, dhe ambientit shkollorë .

- Mosrespektimi i rregullave të mirësjelljes/etikës.

- Mosdorëzimi me kohë i librave, materialeve dhe pajisjeve që janë marrë nga biblioteka apo kabinetet e shkollës.



b) Sjelljet që ndëshkohen me “qortim”:

·Mosrespektimi dhe sjelljet arrogante ndaj administratorëve, punonjësve dhe nxënësve tjerë.

·Mosmarrja parasysh e rregullave të shkollës, prishja e rendit në klasë, pengimi i aktiviteteve mësimore dhe jashtë mësimore.

·Informimi jo i saktë i drejtorisë së shkollës, shprehia për të gënjyer, kopjimi, bërja e ndyshimeve në dokumentet zyrtare.

·Mospjesëmarrja pa justifikim në ceremonitë/manifestimet e organizuara edhe pse gjendet në shkollë si dhe sjelljet e pahijshme gjatë ceremonive.

·Mosrespektimi i rregullave të uniformës.

·Dëmtimi i inventarit shkollorë.

·Përdorimi i gjësendeve të huaja pa leje.

·Dëmtimi me paramendim i gjësendeve të nxënësve tjerë.

·Sjelljet që prishin rendin, procesin mësimor dhe aktivitetet e lira.

·Përdorimi i ambientit dhe inventarit shkollorë pa leje dhe me qëllime jo arsimore.

c) Sjelljet që shkaktojnë “suspendim” nga shkolla:

·Përsëritja për herë të 3-të e sjelljeve që ndëshkohen me Vërejtje ose Qortim.

·Insistimi në shkeljen e rregullave të uniformës.

·Insistimi për mosrealizimin e detyrave të dhëna, projekteve apo përgjegjësi të caktuara.

· Organizimi i veprimeve që do ta pengojnë veprimtarinë e shkollës



- Kërcënimi i mësimdhënësve dhe drejtorisë së shkollës, fyerja / ofendimi i personalitetit, nderit me gojë ose me shkrim, bërja e propagandës kundër shkollës ose institucionit në kuadër të së cilës funksionon shkolla si dhe formimi i grupeve me qëllime propaganduese.

- Ardhja në shkollë i dehur, konsumimi i duhanit apo sjellja me vete.

- Organizimi pa leje i shëtitjeve, koncerteve, konferencave për shtyp etj. Në emër të shkollës apo pjesëmarrja në këto organizime si dhe shpërndarja e broshurave ose formimi i klubeve-grupeve me qëllime të tilla.

- Grumbullimi i ndihmave dhe të hollave në emër të një institucioni ose oragnizate.

- Sjelljet joetike.

- Rrahja apo pjesëmarrja në përleshje.

- Transmetimet pa leje dhe jo të mira në lidhje me shkollën ose persona të tjerë.

- Bartja e armëve të ftohta prerëse, shpuese dhe vdekjeprurëse (thikë, armë etj.)

- Marrja e fletëprovimit pa leje para mbajtjes së provimit.

- Dëmtimi i gjësendeve të huaja, shprehia e përdorimit të tyre pa leje.

- Bërja shprehi e përdorimit dhe shfrytëzimit të inventarit, materialit dhe hapësirës shkollore pa leje dhe me qëllime të caktuara si dhe pjesëmarrja në veprimtari të tilla.

- Brenda dhe jashtë shkollës propagandimi i partive, sindikatave dhe pjesëmarrja në veprimtari të tilla.

- Sjellja ose mbajtja në hapësira të shkollës e personave që nuk kanë të bëjnë me shkollën.

- Lejimi i personit tjetër për të hyrë në provim në vend të vet ose hyrja në provim për dikë tjetër.



d) Sjelljet që shkaktojnë përjashtimin/transferimin nga shkolla:

- Nxënësi i cili gjatë vitit shkollor ndëshkohet me qortim, suspendim apo përjashtim nga shkolla nuk i jepet fletëfalenderimi, çertifikata e suksesit ose fletënderimi.
- Ngacmimi, shpifja, kërcënimi dhe abuzimi ose nxitja e të tjerëve për veprime të tilla.
- Të folurit keq për dikë, qortimi dhe dallimi i personave ose grupeve në bazë të gjuhës, racës, gjinisë, mendimit politikë ose besimit si dhe pjesëmarrja në veprime të tilla.
- Veprimet nxitëse që shkaktojnë ndarje në baza gjuhe, race, ngjyre, feje ose tarikati; formimi i grupeve dhe klubeve pa leje.
- Dëmtimi me paramendim i objektit, aneksit dhe pajisjeve shkollore, inventarit që mund të bartet dhe asaj që nuk mund të bartet.
- Sjelljet agresive ndaj drejtorisë/administruesve, mësimeve dhe punonjësve tjerë brenda dhe jashtë objektit, organizimi ose nxitja e sjelljeve të tilla.
- Shkaktimi i qëllimshëm i zjarrit në shkollë dhe rreth shkollës.
- Sjellja e pijeve alkoolike ose narkotike, nxitja e të tjerëve për përdorimin e lëndëve narkotike.



RREGULLORJA PËR OLIMPIADË DHE PROJEKTE

·Varësisht prej suksesit të treguar në olimpiadë, nxënësit e shkollës së mesme shpërblehen si vijon:

OLIMPIADË	VENDI I	VENDI II	VENDI III
NIVEL KOMUNE	100 €	75 €	50 €
NIVEL VENDI	300 €	200 €	100 €
NIVEL NDËRKOMBËTAR	1000 €	750 €	500 €

· Suksesi i fituar në projekte ndërkombëtare shpërblehet si më poshtë:

PROJEKTI	VENDI I	VENDI II	VENDI III
NIVEL NDËRKOMBËTAR	200 €	150 €	100 €

·Nxënësit e suksesshëm në olimpiadat në nivel të komunës shpërblehen vetëm me të holla. Nuk përfitojnë bursë ose zbrije për shkollim.

· Nxënësit e shkollës së mesme nëse tregohen të suksesshëm në olimpiada në nivel të vendi atëherë ata përfitojnë :

Vendi I-rë : 100 %
Vendi II-të : 80 %
Vendi III-të : 70 %

Zbritje në pagesë të shkollimit dhe të drejtën e shkollimit në cilëndo shkollë prej shkollave tona (zbritjet vlejné vetëm për një vit)

· Nxënësi, i cili për arsye të ndryshme largohet nga ekipi i olimpiadistëve, i humbë të gjitha të drejtat që i janë dhënë më parë me këtë status.

· Nëse nxënësi nga shpërblimet e lartëpërmendura ka fituar më shumë se njërën atëherë i jepet vetëm ajo që e ka vlerën më të lartë. Nxënësi që merr pjesë në olimpiadë nuk i premtohet bursë universitare.

· Nxënësit që marrin pjesë në Olimpiadën e gjuhës turke i marrin vetëm shpërblimet e caktuara nga organizatori. Nuk marrin shpërblime të tjera.



Çfarë do të Gjeni tek Ne!

Klasa të pajisura
me teknologjinë
më të lartë

Kabinete shkencore
dhe kabinete
të informatikës.

Gjuhë të
Huaja

Kurse universitare,
TOEFL dhe SAT

Bursa për
më të mirët

Qëndrim në
konvikte

Gara
Ndërkombëtare

Gara
Kombëtare



Institutionet Arsimore Gulistan

Tel: +386 49 770 515;
gulistankosova.com;
info@gulistankosova.com



Mehmet Akif College-Lipjan

Banullë, Lipjan
+381 38 581 999; +386 49 770 514;
mackosova.com; info@mackosova.com



International School of Prishtina

Marigona Residence, Prishtinë
+386 49 770 513; +386 49 425 216;
ispkosova.com; info@ispkosova.com



Mehmet Akif College - Gjakova

Rr. Zidi Sadikagës, ishTMK, Gjakovë
+386 49 773 775; +377 44 773 775
macgjakova.com; info@macgjakova.com



Mehmet Akif College - Prizren

Boka, Korishë, Prizren
+377 44 140 900
+381 29 233 441; +381 29 222 402
macprizren.net; info@macprizren.net;



Kopshti & Shkolla fillore "Yllka"

Rr. Fan Noli, Prizren
+381 29 233 237; +377 44 669 665;
yllka.net; info@yllka.net